



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Prania / Dorezuar Pamirë / Prilato Received / Delivered	17 - 08 2022	2	viti god year
Organ Bërsa Organ / Jedinstva Org. / Unit	Nr. Prot Pr. / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	4780/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.591/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 591/2022 të datës 04.07.2022 të parashtruar nga ankuesi për mes shoqërisë së avokateve me adresë banimi: kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.591/2022, e datës 04.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. ANULOHET Vërtetja me shkrim me numër 08-1601-0054782/22, e datës 10.06.2022, e Shefit të Sektorit për Urbanizëm në Komunën e Mitrovicës.
- III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e tij, duke e hequr masën disiplinore nga dosja e ankuesit në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit _____ i punësuar sipas Akt Emërimit 11.10.2012 në pozitën Urbanist në Komunën e Mitrovicës së Jugut, udhëheqësi i drejtpërdrejt më datë 10.06.2022 i ka shqiptuar masën disiplinorë *Vërejtje*, me arsyetimin që nuk ka vepruar në kohë lidhur me kërkesën e palës për rrënimin e një objekti pa leje si dhe sjellje të e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit.

Ankuesi, me datë 04.07.2022, me numër protokolli 3890/2022, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, kundër vërejtjes me shkrim me numër 08-1601-0054782/22, të datës 10.06.2022, të Shefit të Sektorit për Urbanizëm në Komunën e Mitrovicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Mitrovicës. Ndërsa Këshilli me datë 26.07.2022, ka pranua nga Komuna e Mitrovicës, përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 4326/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 591/2022 të datës 04.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetje me shkrim me numër protokolli 08-116/01-0054782/22; Deklaratë e datës 13.06.2022, e _____ Kërkesë e datës 17.05.2022; Deklaratë e datës 13.06.2022, e _____ Akt Emërimi i datës 16.10.2012; Përshkrimi i detyrave të Punës; Kërkesë e datës 19.04.2022, për vendosjen e panos reklamuese; Peticion për largimin e muraleve e datës 29.03.2022; Kërkesë e datës 26.04.2022, nga _____ për leje rrenim; Përgjigje në ankesë e datës 26.07.2022, me numër protokolli 4326/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Florent Abrashi, është e *bazuar*, sepse:

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që vërejtja është dhënë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale për faktin që nuk janë shqyrtuar asnjë nga rrethanat e rastit, sepse nuk është bërë saktë konstatimi i shkeljet dhe nuk janë shqyrtuar fare faktet që pala që ka parashtruar kërkesë për leje ndërtimi ende pa kaluar afati për shqyrtim të kërkesës i njëjti ka bërë rrënimin, po ashtu nuk janë shqyrtuar edhe provat ku është paraqitur peticioni nga banorët e objektit ku kundërshtojnë vendosjen e reklamës në ndërtesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së masës disiplinore vërejtje të datës 10.06.2022 të shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ndaj ankuesit, ka konstatuar që pala me datë 26.04.2022, ka paraqitur kërkesë me numër protokolli 08-350/02-0037484/22, për leje rrënimi, po ashtu 19.04.2022 është parashtruar kërkesa nga për vendosjen e panos reklamuese. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore vërejtje të datës 10.06.2022, ka konstatuar se ankuesi me mos shqyrtimin e kërkesës së datës 26.04.2022 të palës dhe kërkesës së datës 19.04.2022 të ka bërë shkelje të detyrave të punës duke mos i shqyrtuar brenda afateve ligjore.

Lidhur me përgjegjësin disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i'u referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*. Ndërlidhur me këtë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë kualifikuar shkeljet e rënda të detyrave të punës: *"Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë"*. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar". Bazuar në këtë mos përmbushja e detyrave të punës dhe mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda hyjnë në kuadër të shkeljeve të rënda disiplinore, ndërsa udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit në masën e shqiptuar ka vlerësuar se ankuesi ka bërë shkelje të lehta të ndërlidhura me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar"*, në këtë rast udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit nuk ka vlerësuar drejtë natyrën e shkeljes së supozuar nga ana e ankuesit.

Bazuar në provat e lëndës, pala i cili ka parashtruar kërkesë më datë 26.04.2022 për leje rrënimi, mirëpo ende pa kaluar afati për shqyrtim të kërkesës e njëjti ka bërë rrënimin e objektit konkretisht më datë 06.05.2022 për këtë pala më datë 13.06.2022 ka dhënë deklaratë me shkrim se rrënimi është bërë pa përgjigjen e komunës sepse ka pasur marrëveshje me kompaninë e ndërtimit dhe ata donin të tërhiqen nga marrëveshjes për ndërtim. Sa i përket mos shqyrtimit të kërkesës së datës 19.04.2022 të palës për vendosjen e panos reklamuese, Kolegji në bazë të gjitha provave, konstaton se përfaqësuesi i kësaj pale më datë 13.06.2022 përmes deklaratës ka që zyrтари ka filluar ta shqyrtoj kërkesën ku na ka njoftuar që disa nga banorët e ndërtesës janë ankues për mos vendosjen e muralit. Jemi njoftuar nga zyrтари që ka dal në teren...lënda ke qenë në procedurë të shqyrtimit për shkak të specifikës dhe ndjeshmërisë së saj. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, si dhe deklaratave të lartcekura, konstaton se Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcakton se: "Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj", në këtë rast ankuesi nuk ka shkëlur asnjë afat ligjor për shqyrtim të ankesën duke marr parasysh edhe faktin që pala ka bërë rrënimin e objekti ndërsa rasti tjetër është specifik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka marr për bazë dispozitat e nenit 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit", sepse masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit nuk është mbështetur me prova relevante konkrete e që mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka qenë i detyruar të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil, siç parashihet me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse vet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit nuk ka arritur të konstatoj se cilat çështje konfidenciale i ka shpërfaq dhe cilin prej nëpunësve civil e ka penguar në punë s e tij zyrtare, sepse ankuesi vetëm ka kërkuar ndihmë nga juristi i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizim përmes kërkesë së datës 17.05.2022 dhe emailit të datës 18.05.2022, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit përveç që është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura, e njëjta është e paligjshme në kuptim të nenit 48 dhe nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njëjësie së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së janë të obliguar që të bëjnë heqjen e masës disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e tij sipas këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 591/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshtef SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së